

PARTNERITETI, ALEAT STRATEGJIK I NJË SAI.

*nga Miranda HAXHIA – Audituese e lartë,
botuar në gazetën “Ekonomia”, më 10 janar 2014.*



Në fushën e auditimit, një vend të rëndësishëm zënë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura nga SAI-t e ndryshme. Zgjedhja e partnerit si një aleat strategjik i një SAI e bën sa të besueshme aq dhe eficiente marrëveshjen.

A duhet të zgjedhim partnerët apo duhet të bëjmë aleanca me partnerët?

Zgjedhja e partnerit, krijon aleanca të sigurta të cilat çojnë në strategji të reja, ku në fund të gjitha kanë një qëllim, “luftën kundër korrupsionit”.

Pikërisht para kësaj sfide është vënë dhe KLSH, ku me nismën e Kryetarit të saj z. Bujar LESKAJ, ka bërë zgjedhjen e partnerëve të saj. Në vazhden e këtyre marrëveshjeve një vend të veçantë zë dhe marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur mes KLSH dhe Autoritetit të Konkurrencës. Nisma e Kryetarit të KLSH në nënshkrimin e një marrëveshjeje të tillë, përbën dhe një ndër sfidat e tij në luftën kundër korrupsionit duke e vënë KLSH-në gjithnjë në “start”.

Nëse shohim veprimtarinë e këtyre dy institucioneve me të drejtë pyesim, ku qëndron bashkëpunimi mes këtyre dy partnerëve? Ku janë pikat e takimit të tyre dhe ku ndahen ato?

Për të dhënë një ide të qartë të këtij bashkëpunimit mjafton të hedhim një vështrim në fushën e prokurimeve publike, çfarë përbën për njërin institucion auditimi i

prokurimeve publike dhe çfarë do të thotë për institucionin tjetër, auditimi i prokurimeve publike.

Auditimi i fondeve të përdorura nga buxheti i shtetit për prokurimet publike, përbëjnë dhe një ndër drejtimet e programit të auditimit, sipas standardeve të KLSH-së dhe të INTOSAI-it, për auditimin e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, me qëllim që të auditohet përdorimi i tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Pikërisht auditimi i plotë dhe objektiv nga ana e KLSH-së i prokurimeve publike, ndihmon njëkohësisht në parandalimin dhe zbulimin e “marrëveshjeve të ndaluara” në ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë për pjesëmarrjen në tendera, e cila përbën sinjal për Autoritetin e Konkurrencës.

Nëse i referohemi një analize të thjeshtë të bërë në procesin e auditimit mbi prokurimet publike, 4 komponentëve mbi Tregun-**T**, Aplikimet-**A**, Modelet-**M** dhe Sjelljen e dyshimtë-**S**, ku secili nga këto komponentë, përbën 4 shtyllat e një katërkëndëshi ose të ashtuquajturin TAMS¹, dhe ku çdo shtylle i përgjigjet një sjellje dhe zbulim i veçantë, do të shikojmë se analiza e fenomeneve të këtyre shtyllave apo analiza e TAMS-it e kryer nga secili prej këtyre partnerëve në marrëveshje, përbën dhe eficiencën e saj në rastin e auditimit të prokurimeve publike.

Auditimi i shtyllës së parë ose Tregu-**T**, është i rëndësishëm për dy palët në marrëveshje si për KLSH-në ashtu dhe për Autoritetin e Konkurrencës. Por cilët janë këndvështrimet e këtyre partnerëve në një auditim mbi prokurimet publike.

Gjatë auditimit të prokurimeve mbi **T**-Tregun, shpesh lind pyetja:

Cili është në treg për këtë ofertë ose kush ka ofertuar për këtë ofertë?

¹ Fletë palosje botimi i financuar nga BE në kuadër të projektit të asistencës teknike “Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Departamentin e Ndihmës Shtetërore”

Nga pikëpamja e auditimit, KLSH-së i intereson të auditojë se a ka qenë pjesëmarrja e konsiderueshme në këtë apo atë tender, në mënyrë që të vlerësojë transparencën në procedurat e prokurimit, ndërsa nga këndvështrimi i Autoritetit të Konkurrencës, auditimi i fenomenit të pjesëmarrjes në tender nga ana e KLSH-së është i rëndësishëm për faktin se jep sinjale për rrezikun e një “marrëveshjeje të ndaluar”. Si transmetohen këto sinjale te Autoriteti i Konkurrencës? Në cilat raste?

Nëse KLSH, gjatë auditimit të prokurimeve publike konstaton se:

- janë paraqitur pak Operatorë Ekonomikë që ofrojnë mallra, shërbime apo punë,
- kur i njëjti Operator Ekonomik ose një grup i vogël Operatorësh Ekonomik konkurrojnë gjithmonë duke kontrolluar pjesën më të madhe të tregut,
- kur kriteri përcaktues në shpalljen e ofertës fituese është çmimi dhe jo kritere të tjera konkurruese si cilësia, dizenjimi apo shërbimi,

atëherë në kuadër të këtij bashkëpunimi, ajo duhet të sinjalizojë dhe Autoritetin e Konkurrencës për këto fenomene të konstatuara nga ana e saj, por tashmë për t'u analizuar në një këndvështrim tjetër nga ky partner, nga pikëpamja e rrezikut të një “marrëveshjeje të ndaluar”.

KLSH, nga auditimi i kësaj çështjeje, përse i përket pjesëmarrjes në prokurimet publike të ofertuesve, në përfundim të auditimit për të përmirësuar gjendjen jep rekomandime nga ana e saj në lidhje me mungesën e transparencës në rastet kur ajo konstatohet, duke luftuar në këtë mënyrë korrupsionin nga zyrtarët publikë për shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, ndërsa Autoriteti i Konkurrencës nga sinjali që i jep KLSH mbi transparencën për pjesëmarrje të Operatorëve Ekonomikë, parandalon rrezikun e një “marrëveshjeje të ndaluar” nga ana e tyre, e për rrjedhojë siguron konkurrencë të ndershme në treg. Bashkëpunimi mes këtyre partnerëve e në sinkron të plotë ndihmon secilin në arritjen e objektivave të veprimtarisë së tyre dhe çon në arritjen e një qëllimi të përbashkët nga ana e tyre “luftën kundër korrupsionit”.

Auditimi i shtyllës së dytë ose Aplikimi-**A**, i cili është po aq i rëndësishëm sa i pari, ka lidhje me fenomene të tilla si: A ka ngjashmëri mes kërkesave/propozimeve të Operatorëve Ekonomikë? Cilat janë këndvështrimet e partnerëve për këtë çështje? Auditimi i këtij fenomeni nga pikëpamja e KLSH-së, ka të bëjë me procesin e shqyrtimit të ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë, të cilat nëse i auditojmë me kujdes duke i bërë një analizë të thellë, konstatojmë shpesh se shkeljet që vërehen në shqyrtimin e ofertave, na japin sinjale të një “marrëveshjeje të ndaluar”, sinjal të cilin duhet t’ja transmetojmë Autoritetit të Konkurrencës. Në mënyrë të përmbledhur nëse gjatë auditimit të ofertave në prokurimet publike konstatojmë se:

- dy a më shumë oferta mund të kenë të njëjtin shkrim dore apo të njëjtat gabime gramatikore/matematikore në formularët e plotësuar prej tyre;
- dy a më shumë oferta mbajnë të njëjtën adresë e-mail apo numër telefoni/fax;
- kur karakteristikat e një dokumenti të një apo dy ofertave elektronike tregojnë që janë krijuar ose ndryshuar nga i njëjti operator ekonomik,

atëherë në kuadër të bashkëpunimit duke kombinuar këto sinjale i transmetojmë tek Autoriteti i Konkurrencës, por tashmë për t’u analizuar në një këndvështrim tjetër nga ky partner, pra nga pikëpamja e rrezikut të një “marrëveshjeje të ndaluar”, ndërsa për KLSH, konstatimi i këtyre fakteve ka rëndësi për vlerësimin objektiv të operatorëve ekonomikë nga Autoriteti Kontraktor, duke shmangur shkeljet e konstatuara në vlerësimin e ofertës më të mirë të mundshme e cila çon në shmangien e një procesi të rregullt konkurrues.

Nëse nga auditimi i shtyllës së tretë Modelet-**M**, shqyrtohen rezultatet e ofertave të mëparshme/apo ofertat e paraqitura nga njëri tender në tjetrin brenda të njëjtit vit buxhetor për mallra, shërbime apo punë publike rezulton se:

- gjatë ofertimeve të njëpasnjëshme të operatorëve ekonomikë, dalin fitues në disa tendera njëkohësisht i njëjti operator ose në vazhdim mbi bazën e parimit të rotacionit,
- të njëjtët ofertues gjatë ofertimeve të njëpasnjëshme dalin fitues për kufi monetar të njëjtë ose të përafërt,
- gjatë ofertimeve të njëpasnjëshme del fitues i njëjti operator ekonomik,
- krahasuar me ofertat e mëparshme në tenderin në fjalë paraqesin oferta një numër e më i vogël operatorësh ekonomikë,

atëherë Kujdes!. Ekziston rreziku i një “marrëveshjeje të ndaluar” sinjalet e të cilës duhet t’ja transmetojmë Autoritetit të Konkurrencës.

Auditimi i shtyllës së katër, Sjellja e dyshimtë-S, që lidhet me demonstrimin nga ana e operatorëve ekonomikë të sjelljeve të tilla si:

- kur një ofertues dorëzon kërkesë për prokurim dhe ju jeni në dijeni që ofertuesi nuk ka mundësi që të ofrojë të mirat dhe shërbimet e kërkuara;
- një ofertues i vetëm sjell propozime të shumta për një proces ofertomi;
- një ofertues bën deklaratë me telefon, fax/e-mail duke treguar se ka njohuri mbi çmimet e një konkurrenti tjetër ose mundësitë e tij për të fituar ofertën,

atëherë këto sjellje tregojnë se ofertuesit kanë bashkëpunuar me njëri tjetrin dhe jo se kanë konkurruar për të fituar tenderin, marrëveshja në oferta ka ndodhur dhe kjo për bën sinjalin për tu transmetuar te Autoriteti i Konkurrencës.

Siç shihet nga analiza e thjeshtë e këtyre fenomeneve gjatë auditimit të procedurave të prokurimit publik, ku për njërin partner-KLSH-në, përbëjnë konstatime në një procedurë prokurimi, ndërsa për partnerin tjetër-Autoritetin e Konkurrencës përbëjnë sinjale të një “marrëveshjeje të ndaluar”, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin arrijnë rezultate në luftën kundër korrupsionit.

Zgjedhja e partnerit çon në aleanca të sigurta.